

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The **Albanian**

VITI I 21 I BOTIMIT 10 MAJ 2025

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

MASAT E ASHPRA TË STARMER NDAJ EMIGRACIONIT



PETRIT KUÇANA

**A ËSHTË
KOHA PËR
REFLEKTIM?**



ARBEN MANAJ

**THE TIMES
PARALAJMËRON
PËR PLANE RADIKALE
ANTI-EMIGRACIONI
NË ANGLI**


**RAPORT I RI,
REFREN I VJETËR**

LUTFI DERVISHI



**NJË SHEMBULL PËR KOSOVËN:
SI U ARRIT MARRËVESHJA
PËR KOALICION NË GJERMANI?**

ENVER ROBELLI



**"MBRETËRIA E
ÇYRYKËVE"**

JETA DEDJA



**PSE U RRIT
EDI RAMA?**

ANDI BUSHATI



**DUKE KËRKUAR QENDRËN:
KRIZA E HESHTUR
KOSOVARE (DHE EVROPIANE)**

VETON SURROI



E ARDHMJA FILLON TANI

Dotech
websites

**JEPI FRYMËMARRJE
BIZNESIT TËND**



PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TE VINI NË
ZYRAT TONA

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545


The Albanian newspaper in London


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Vështirësisht e shpjegueshme është ajo çfarë ndodh në Shqipëri, sidomos për ndonjë mik anglez që nuk është aq i përditësuar me realitetin shqiptar. Tmerrësisht e vështirë është t'u shpjegosh edhe të rinjëve shqiptarë të lindur në emigracion, se pse Shqipëria po shkon drejt fundit të demokracisë. Vërtet si mund t'i shpjegohet dikujt fenomeni i 'patronazhimit'? Si mund të shpjegohet se në Shqipëri anti-opozitarizmi mbetet profesioni

KOHA PËR REFLEKTIM

më i paguar? Është goxha e vështirë që tu shpjegosh qoftë edhe shqiptarëve të Kosovës, apo qytetarëve të tjerë në rajon, pasi kanë dëgjuar për gjithë ato skandale të tmerrshme të qeverisë, ministrave, kryebashkiakëve, por...se ajo rezultojnë sërish e para në zgjedhje. A është "çyrykëzimi" sindroma allashqiptare që, mjerisht, po rezultojnë frytdhënëse për kryeministrin që e ka kthyer në të padukshëm kufirin mes partisë dhe shtetit?

Të gjitha këto vazhdojnë të renditen në raportet ndërkombëtare, që duket sikur janë copy-paste e raporteve të mëpërparshme por 'patronazhimi' vijon krejtësisht i qetë punën e vet, duke u përkëdhelur vazhdimisht nga kryeministri dhe shpura e tij.

E nëse gjithçkaja atje rrokulliset në hullitë e autokracisë, media mjerisht del sërish në raportet ndërkombëtare si pamundësi për të mbrojtur interesin publik.

Vërtet a po e mbron media shqiptare interesin publik?

Deri më sot nuk kemi asnjë skandal të zbuluar nga media, çka do të ishte mëse e natyrshme, por raportimet janë që mediat janë bërë pjesë e korrupsionit. Si është e mundur që një 'analist' në Shqipëri paguhet më mirë se një gazetar në Britani?

A ka diçka që nuk shkon këtu?

Ka qenë tejet skandaloze ajo që ndodhi në ditën e fundit të fushatës elektorale ku kryeministri u gjend para gazetarëve në 'Opinion'. Cilat mund të jenë fjalët që të përkrahajnë atë zallamahi kryeministore, ndaj disa pyetjeve krejtësisht të thjeshta normale?

Duke që kryeministri i pamësuar më përballje të tilla normale, me atë gjuhë dhe sjellje rrugaçerore, llagaridhënia i duket diçka që nuk ka pse i duhet... kur ka mediat që mjerisht



kthehen në zëdhënëse të tij. Kjo kalon krejtësisht në heshtje. Asnjë solidarizim me kolegët gazetarë, asnjë mbështetje njerëzore ndaj zonjave gazetare, deri në kufinj të paturpshmërisë, pasi sistemi nuk e lejon kurrësesi këtë... Imagjinoni nëse kjo do të ndodhte qoftë edhe në Kosovë... e lere në një vend tjetër të Evropës. Mbase mjafton ai fragment televiziv për të kuptuar për gjithçkanë që ndodh në Shqipëri. E pasi të shikojnë kryeministrin e ner-

vozuar me gazetarët, mbase do të ishte më e lehtë tu shpjegosh të huajve fenomenin allashqiptar, që në kryeqytetin ku arrestohet kryebashkiaku, fitohet edhe më shumë vota dhe se skandalet mbyllen, harrohen, për të kaluar tek të tjerët që mjerisht duket se nuk kanë të mbaruar në vendin tonë.

Mbase është tejet e qartë për gjithkënd, se përderisa anti-opozitarizmi do të mbetet profesioni më i paguar dhe 'patronazhimi' do të mbetet process normal i përkëdhelur nga pushteti, pikërisht aty do të fillojë fuqia e autoritarizmit...

Duket se në këto kushte në Shqipëri rotacioni mbetet i pamundur dhe se rruga drejt autoritarizmit mbetet tejet e sigurtë.

Mbase është koha për reflektim nga çdokush, për gjithçka...

Ka ardhur koha që "të rivendosim kontrollin mbi kufijtë tanë", kështu është shprehur kryeministri laburist Keir Starmer.

Këto kanë qenë ndoshta fjalët më të ashpra ndonjëherë të thëna nga një lider i së majtës për këtë çështje këtë mëngjes në konferencën për shtyp në Downing Street: një gjuhë që organizatat në mbrojtje të emigrantëve e cilësojnë si "të turpshme dhe të rrezikshme", ndërsa disa deputetë të së majtës laburiste e thanë se kjo deklaratë ishte "çnjerezore dhe përçarës".

Me një gjuhë që ngjante me atë të mbështetësve të Brexit-it dhe të së djathtës populiste, ai njoftoi një reformë të re për sistemin e emigracionit, me synimin për ta ulur ndjeshëm numrin e emigrantëve.

MASAT E ASHPRA POPULISTE TË STARMER NDAJ EMIGRACIONIT

Ndërkohë, nga partia e Nigel Farage u shprehën se "më në fund po na dëgjon dhe po mëson nga ne". Konkretisht për të marrë një vizë për në Britaninë e Madhe, do të kërkohet një njohje e avancuar e gjuhës angleze edhe nga familjarët e emigrantëve dhe një diplomë universitare për punët e kualifikuara.

Në të njëjtën kohë, koha e nevojshme për të marrë qëndrim të përhershëm,

hapi i parë drejt shtetësisë, do të rritet nga pesë në dhjetë vjet.

Përjashtim do të bëhet për ata që japin një kontribut të rëndësishëm, si mjekët dhe inxhinierët, sepse siç u shpreh Starmer "të jetosh këtu nuk është një privilegj që duhet ta fitosh".

Është një pikë kthese që nuk vjen rastësisht, por mbi valën e suksesit

elektoral të partisë së Farage në zgjedhjet e fundit vendore, parti që e ka bërë emigracionin kauzën e saj kryesore, sidomos tani që kjo çështje është rikthyer në krye të shqetësimeve të opinionit publik.

Sepse, ndryshe nga sa ishte menduar, pas Brexit-it emigracioni në Britaninë e Madhe është përhapur shumë, duke arritur në 1.3 milionë ardhje në vit (dhe këtu bëhet fjalë për emigracionin e ligjshëm, jo për më pak se 50 mijë

kalimet ilegale përmes Kanalit të La Manshit, që janë vetëm një pikë në oqean).

Starmer ia hodhi fajin qeverive të mëparshme konservatore, duke deklaruar se ajo që ndodhi "nuk ishte rastësi, por një zgjedhje", dhe shpalli si të dështuar "eksperimentin e kufijve të hapur" që ata kishin ndjekur. "Tani u takon laburistëve të pastrojnë rrëmujën," u shpreh ai.

Deputetja britanike Emma Lewell-Buck, në një letër të nënshkruar nga shumë deputetë të tjerë, i është drejtuar me një letër të hapur Sekretarit të Shtetit për Punë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, duke shprehur shqetësimin e thellë për pjesëmarrjen e Presidentit serb Aleksandar Vuçiq në paradën ushtarake në Moskë, më 9 maj, në krah të Presidentit rus Vladimir Putin.

Në letrën e saj, deputetja Lewell-Buck thekson lidhjet e ngushta mes regjimit të Vuçiqit dhe Kremlinit, duke përmendur se Serbia është i

vetmi vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian që nuk ka vendosur asnjë sanksion ndaj Rusisë, pavarësisht agresionit të saj brutal kundër Ukrainës që nga viti 2014. Ajo gjithashtu ngre shqetësime serioze për përpjekjet destabilizuese të Vuçiqit në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë dhe në të gjithë rajonin e Ballkanit.

Letra nënvizon regresin demokratik në Serbi nën sundimin e Vuçiqit, përfshirë sulmet ndaj mediave të lira, opozitës politike dhe shoqërisë civile, si dhe korrupsionin e përhapur që ka nxjerr protestat të mëdha qytetare. Deputetja britanike vëren se përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të

Mbretërisë së Bashkuar për të mbështetur rrugën euroatlantike të Serbisë, regjimi aktual ka treguar qartë përkushtimin e tij ndaj aleancës me Rusinë dhe promovimin e ideologjisë destabilizuese të "Serbisë së Madhe".

Për këtë arsye, ajo i bën thirrje qeverisë britanike që të ndërmarrë masa

të menjëhershme, duke përfshirë vendosjen e sanksioneve të synuara ndaj Presidentit Vuçiq, qeverisë së tij dhe bashkëpunëtorëve të afërt. Ajo nënvizon se një reagim i qartë dhe i vendosur është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë dhe stabilitetin në Ballkan dhe për të ruajtur vlerat demokratike në rajon.

DEPUTETJA BRITANIKE EMMA LEWELL-BUCK I BËN THIRRJE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË VENDOSË SANKSIONE NDAJ SERBISË

You **Talk**
We **Listen.**

4.9^{/5}



Because your case isn't just another file — it's your life.

**Secure
your right
to work,
live and be
FREE in the
UK.**



Meet

OLIVERTA MEDIU

Solicitor, Partner

+44 (0)20 7063 9040

Call now to book your confidential consultation!

079 4603 5736

o.mediu@wslegal.co.uk

Leicester Office:
3rd Floor, St. George's House, 6 St George's
Way, Leicestershire, LE1 1QZ, UK

Head Office:
2nd Floor, 2-5 Minories,
London EC3N 1BJ

Immigration Law:

- Visa applications & appeals (work, student, spouse, etc.)
- Indefinite Leave to Remain (ILR) & British citizenship
- Asylum & human rights claims
- Detention, bail, and deportation defense
- Sponsorship & business immigration

Family Law:

- Divorce & separation
- Child custody & visitation rights
- Domestic violence protection orders
- Prenuptial & postnuptial agreements

Providing expert legal support to all—
regardless of race, nationality, age, gender, or identity.



ARBEN MANAJ

Reformat e pritshme që Ministria e Brendshme britanike do të njoftojë javën e ardhshme, mendohet se do të jenë jetësore për përpjekjet e kryeministrit Starmer për të luftuar popullaritetin në rritje të Partisë Reforma, të babait të Brexit-it,

Nigel Farage, partia e të cilit ndodhet 10 pikë përpara Laburistëve në pushtet në sondazhet e opinionit publik dhe i shkaktuan një humbje të thellë dy partive kryesore në zgjedhjet e fundit të pjesshme lokale.

Sipas The Times, në planet e reja anti-emigracion do të kufizohet mundësia e azilkërkuësve që u është refuzuar kërkesa, apo kriminelëve të huaj, që

të përdorin lidhjet e të drejtave të njeriut për të bllokuar riatdhesimin e tyre në vendet e origjinës, përfshirë edhe ata shqiptarë.

Qeveria britanike pritet të ndryshojë ligjin për të kufizuar interpretimin e Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nen i cili mbrohet të drejtën e pasjes së jetës familjare dhe private, që përdoret rëndom për bllokimin e deportimeve nga Britania.

Ministrja e Brendshme, Yvette Cooper, apeloj së fundmi me sukses ndaj një vendimi të Tribunalit të Emigracionit për rastin e një shqiptari të dënuar, i cili kërkoi qëndrimin e mëtejshëm për shkak të vështirësive emocionale, pasi djali i tij dhjetëvjeçar nuk do të mund të hante dot një produkt me mish pule nga ato që gjenden jashtë Britanisë.

Leja e përhershme e qëndrimit për ata që jetojnë në Britani, në planet e reja të qeverisë, pritet të rritet nga 5 në dhjetë vjet pritje për një kategori em-



igrantësh. Po ashtu, pritet të rriten kriteret për testin e gjuhës angleze për të huajt.

Pritet po ashtu të ketë kufizime për dhënie e vizave nga disa vende, shtetasit e të cilave kanë më shumë gjasa të thyejnë vizën britanike apo të

kërkojnë azil, ku përfshihen vende si Pakistani, Nigeria dhe Sri Lanka, por ende nuk përmendet Shqipëria në njoftimet në median vendase.

Në këtë kontekst, interesante pritet të jetë vizita e kryeministrit britanik Starmer në Tiranë javën e ardhshme,

ku mendohet gjerësisht se çështja e qendrave të ngjashme të shqyrtimit të azilit për emigrantët e huaj që mbërrijnë në Britani, si ato me Italinë në Gjadër, pritet të jenë në agjendën e takimit me homologun e tij shqiptar.

Dotech
website

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni ose mund të vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

**TRANSPORT
APOLLONIA**



**TRANSPORT
MAKINASH
ANGLI-SHQIPËRI**

00447429200952

**OFRON SHERBIME TRANSPORTI
MAKINA
MOTORCIKLETA
PJESË MAKINASH
MAKINERI BUJQËSORE
MOBILJE
FASADA XHAMI
DYER & DRITARE, MOBILIERI ETJ**



00355682948843

00355694031009

00447429200952

**TRANSPORT MALLRASH
ANGLI-SHQIPËRI
SHQIPËRI-ANGLI**



www.transportapollonia.co.uk



RAPORT I RI, REFREN I VJETËR

LUTFI DERVISHI

Konferenca e pasdites e vëzhguesve ndërkombëtarë nxorri edhe njëherë në pah jo vetëm standardet, por edhe stereotipet, që në vend që të përshkruajnë realitetin, shpesh e thjeshtojnë atë në klishe.

E tillë ishte edhe ankesa për pjesëmarrjen e ulët në votime. Për vëzhguesin e ODIHR-in, pjesëmarrja prej 42% duket shqetësuese, por askush nuk i ka shpjeguar se numri real i votuesve në Shqipëri, në raport me popullsinë aktuale, i kalon 80%.

Pra, nuk është se shqiptarët nuk votojnë, por se lista e votuesve është fryrë me ata që kanë emigruar dhe nuk mund të votojnë.

Kur Moisiu u paraqit para Faraonit në Egjipt, ai kërkoi lirinë e popullit të tij pas 400 vitesh skllavëri. Në oborrin mbretëror, ku faraonët besonin se ishin zotër mbi tokë, kërkesa për liri tingëllonte si çmenduri. Por Moisiu nuk u ndal. Ai sollti murtajat, shndërroi ujën në gjak, mbushi Egjiptin me bretkosa, e zhyti vendin në errësirë në një përballje epike mes perandorisë dhe shpresës për liri. Moisiu kishte mbështetjen e Zotit. Dhe kur deti u hap si portë e shpë-

Pastaj, vjen klisheja për mediat.

Në raport shkruhet se “autocensura është problem,” por vëzhguesja e ODIHR habitet kur përballet me gazetarë kritikë që bëjnë pyetje të ashpra dhe të drejtpërdrejta. Në realitet, problemi nuk është se nuk ka gazetarë të mirë, por sistemi mediatik është tjetër mesele.

Kur raporti i ODIHR vëren mungesën e debateve në fushatë, harron të përmendë se Shqipëria ka dekada që nuk zhvillon debate dhe gazetarët nuk raportojnë fushatat. Debatet janë zëvendësuar me transmetime live apo të regjistruara. Fushata raportohet nga partitë dhe gazetarët janë spektatorë në rastin më të keq apo punonjës fasonerie që punojnë me material të porositesit.

Gazetarët sot vunë në dukje me

shqetësim, përkeqësimin e rolit të policisë gjatë zgjedhjeve, por përgjigjia që morën nga vëzhguesit ishte e papritur: “Ne nuk jemi policë.”

Një moment epik që tregon sesa larg është vëzhgimi nga realiteti i terrenit. Dhe qershia mbi tortë: problemi nuk është vetëm përdorimi i administratës publike për qëllime elektorale, vendimet financiare të qeverisë për favore zgjedhore, frikësimi i votuesve apo shitblerja e votës.

Të gjitha këto janë të vjetra. Problemi është se raporti nuk arrin të thotë nëse këto fenomene janë përmirësuar apo përkeqësuar që nga zgjedhjet e fundit. Përkundrazi, lista e rekomandimeve përsëritet çdo katër vjet, pa ndonjë përpjekje serioze për të matur progresin apo regresin.



Rekomandimet e ODIHR-it nuk janë të shkurtra, por të përsëritshme. Ndoshta është koha që të kemi vetëm

një rekomandim: adresoni listën e vjetër të rekomandimeve.

UDHËTIMI I PAMBARUAR

timit, ai udhëhoqi popullin drejt lirisë, duke kaluar me ta në bregun tjetër.

Sipas hartave të kohës, rruga nga Egjipti në Tokën e Premtuar ishte rreth 4 ditë në këmbë. Por udhëtimi zgjati 40 vjet.

Pse?

Që ditën e parë të udhëtimit,

njerëzit nisën me ankesat: “Ku është buka?” “Ku është uji?” “Te Faraoni të paktën kishim për të ngrënë!”

Gjatë rrugëtimit, Moisiu u ngjit në malin Sinai për të marrë e gdhendur, ligjet e drejtësisë, 10 urdhëresat! Po kur zbriti, e gjeti popullin e tij duke vallëzuar rreth një viçi të

artë, idhulli që simbolizonte të kaluarën.

I dëshpëruar dhe i zhgënjyer, Moisiu ra në gjunjë, ngriti sytë drejt qiellit dhe pyeti:

-O Zot, kur do të bëhen njerëz këta?

Përgjigja që erdhi nga lart ishte e ftohtë dhe e pamëshirshme:

- Derisa të vdesë dhe i fundit që ka lindur në skllavëri...

Kështu, endja e hebrenjve në shkretëtirë zgjati 40 vjet, jo për shkak të distancës, por për shkak të trashëgimisë së frikës dhe nënshtrimit, të cilat duheshin zhdukur para se një popull i zgjedhur të shkelte në Tokën e Premtuar.

Dotech

website 

“ **AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ?** ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929




Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



The Albanian



**NESE JU DUHET NJE DOKTOR
MOS HEZITONI TE VIZITONI
VAL CLINIC**

THE BEST MEDICAL CENTER

OUR SERVICES:

CARDIOLOGY

ENT

PAEDIATRICS

GYNAECOLOGY

DERMATOLOGY

INTERNAL MEDICINE

RADIOLOGY

PHYSIOTHERAPY

NEUROLOGY

SURGERY AND MINOR INJURY

UROLOGY

ENDOCRINOLOGY

GASTROENTEROLOGY

AESTHETIC MEDICINE

PODIATRY

FULL CHECK-UP

PSYCHOLOGY

PSYCHIATRY

DIAGNOSTICS:

ALL TYPE OF BLOOD TEST

AND SWABS AFTER

DOCTORS

CONSULTATION



**Pershendetje,
Dr. Arjola KURTI
dhe Dr.Val punojnë
në VAL Clinic që është një
klinikë në Londër me mjek/e
specialistë të gjithë
sherbimeve mjekesore.
Për çdo problem
na kontaktoni**

NA KONTAKTONI



INFO@VALCLINIC.CO.UK

WWW.VALCLINIC.CO.UK

**39 Frederick Road
Rainham RM13 8NJ**

Tel: 01708701155

Mob: 07307595437

Misioni i vëzhguesve ndërkombëtarë të zgjedhjeve të së dielës theksoi abuzimet nga partia në pushtet me burimet shtetërore si dhe mungesën e medias së pavarur si shqetësimet kryesore ndërsa kreu i delegacionit të Parlamentit Evropian Michael Gahler tha se “Shqipëria nuk mund të hyjë në BE në gjendjen aktuale”.

Misioni i vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR deklaroi të hënën në gjetjet paraprake se gara zgjedhore në Shqipëri ishte “e pabarabartë” për shkak të “keqpërdorimit masiv të burimeve shtetërore dhe pushtetit institucional nga partia në pushtet” si dhe nga mungesa e medias së pavarur, e cila nuk siguroi që votuesit të ishin të mirëinformuar mbi zgjedhjen që bëjnë.

“Ndërsa zgjedhjet u menaxhuan mirë, dëshmitarët afatgjatë dëshmuar frikësim masiv dhe abuzim të burimeve shtetërore gjatë fushatës elektorale,” deklaroi ambasadori Lamberto Zannier, kreu i misionit.

Raporti shënon një kthesë të fortë në gjetjet e misionëve të vrojtimit të zgjedhjeve të shkuara, ku zakonisht vëzhguesit janë mjaftuar duke vënë në dukje se problemet “janë raportuar”, ndërsa në këtë rast, ata vënë në dukje se ata vetë “i kanë dëshmuar” rastet e frikësimit të votuesve dhe abuzimit të burimeve shtetërore.

“Zgjedhjet u shënuan nga keqpërdorimi masiv i burimeve publike dhe fuqive institucionale të partisë në pushtet ndërsa raportime të shumta

OSBE/ODIHR PËR ZGJEDHJET NË SHQIPËRI: PABARAZI, FRIKËSIM, ABUZIM ME FONDE PUBLIKE...



mbi presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe votuesit e tjerë si dhe rastet e frikësimit [të votuesve] ishin shqetësuese,” thuhet në deklaratë.

Duke folur jashtë tekstit të deklaratës së shkurtër, Farah Karimi, koordinatoreja e vëzhguesve afatshkurtër theksoi shqetësimet mbi median dhe po kështu, ambasadori Zannier vuri theksin se monitorimi i medias shqiptare prej tyre zbuloi përdorimin masiv të materialeve të gatshme, si dhe faktin që informacioni i ofruar

nga Autoriteti i Medias Audiovizive “nuk ishte i përdorshëm” dhe se kjo ngre pikëpyetje mbi “pavarësinë e AMA-s”.

Raporti theksoi se rastet e abuzimit me burimet shtetërore “u mbajtën shënim” dhe se kjo është “e papërpunshme me standardet ndërkombëtare”.

“Garuesit në përgjithësi ishin të lirë të kryenin fushatën e vet por fusha e lojës ishte e pabarabartë,” thuhet në

raport. “Partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i gjithëpërhapur i burimeve administrative dhe mekanizmave institucionale, përfshirë heqjen e gjobave pak para ditës së zgjedhjeve, ndërsa zyrtarët e lartë të qeverisë u angazhuan shumë në një numër aktivitetesh zyrtare që shpesh mbivendoseshin me mesazhet e fushatës,” shkruhet më tej në raport.

“Aludimet për presion mbi punonjësit publikë, raste të frikësimit të mbështetësve të opozitës dhe keqpër-

dorimi i rrjeteve të patronazhimit u vërejtën, gjë që është jo në përputhje me standardet ndërkombëtare,” shkruhet më tej.

Shqiptarët votuan në zgjedhje të dielën, zgjedhje të cilat partia në pushtet i fitoi me shumicë votash dhe me shumicë akoma më të lartë mandatesh.

Kjo është maxhoranca më e madhe e krijuar ndonjëherë në Shqipëri që nga viti 2001, kur zgjedhjet u zhvilluan gjithashtu nga Partia Socialiste dhe të cilat, vëzhguesit ndërkombëtarë i dënuan si të pabarabarta.

Kritika të forta vëzhguesit bëjnë veçanërisht në drejtim të medias.

“Mjedisi mediatik ishte shumë pengues, me pavarësinë, larmishmërinë dhe integritetin e përmbajtjes së lajmeve të minuar nga financimet jotransparente, përqendrimi i pronësisë, ndërhyrja në autonominë editoriale dhe ndikimi politik,” shkruhet në raport.

Procesi i numërimit nuk ka mbaruar ende por deri në kohën e publikimit të këtij shkrimi, Partia Socialiste duket se ka siguruar rreth 53% të votave dhe rreth 60% të parlamentit.



ENVER ROBELLI

Nuk ekziston fare as dashuri, as simpati mes dy partive që lidhën koalicion në Gjermani, pra mes demokristianëve (CDU & CSU) dhe socialdemokratëve (SPD). Koalicioni mes partisë së parë dhe të tretë u lidh për shkak të domosdoshmërisë aktuale dhe mungesës së alternativave bindëse.

Gjatë fushatës këto dy parti e akuzuan njëra-tjetren për paaftësi. Shkëmbyen edhe fjalë të rënda. Pasi u mbajtën zgjedhjet dhe rezultati nuk ishte i kënaqshëm për asnjë parti, përveçse për ekstremistët e djathtë, demokristianët dhe socialdemokratët morën përgjegjësi për vendin.

NJË SHEMBULL PËR KOSOVËN: SI U ARRIT MARRËVESHJA PËR KOALICION NË GJERMANI?

Nisën negociatat për koalicion. Arritën marrëveshje për koalicion. Por këtu nuk mbaroi muhabeti.

Meqë kryetarët e partive nuk e konsiderojnë partinë si pronë të tyre, ata vendosën që në procesin e vendim-marrjes të kërkon kongresin përkatës për anëtarësinë.

Demokristianët mbajtën një kongres, i cili përkrahu koalicionin. Socialdemokratët shkuan një hap më tutje: kërkuar nga 358 mijë anëtarë të SPD-së të votojnë online nëse përkrahin apo hedhin poshtë marrëveshjen e koalicionit me demokristianët. 84,6 për qind e anëtarëve të SPD-së votuan për marrëveshjen e koalicionit.

Pse ky model të mos praktikohet edhe në Kosovë? Kryetari i partisë së parë, të dytë e të tretë (e kështu me radhë) e pyet anëtarësinë: jeni për apo kundër koalicionit me këtë apo atë parti? Kësisoj pëlqimi apo refuzimi



do të kishin bazë shumë më të gjerë demokratike se sa vendimi i një rrethi të ngushtë nën ndikimin e kryetarit.

“Ne nuk jemi Gjermani”, do të thoshte ndonjë cinik kujdestar. E vërtetë, por çka jemi? Dhe çfarë mod-

esh politik praktikojmë? Nëse në votimin brendpartiak anëtarësia do të hidhte poshtë një koalicion apo do ta përkrahte atë, kryetari do të kishte argumente të fuqishme në ballafaqim me kritikët e brendshëm.

Momentalisht duket se askush nga klasa politike e Kosovës nuk është i gatshëm të marrë përgjegjësi nga frika se secili po ia bën kurthin tjetrit. Kjo tregon sa i thellë është mosbesimi mes aktorëve politikë. Po të kishte vullnet për qeverisje, ofertat dhe kundërofertat nuk do të bëheshin me pompozitet publik.

Në prapavijë nuk po përjashtohet as skenari i zgjedhjeve të reja parlamentare.

Në një rast të tillë, mund të ketë politikanë që nuk do ta shohin më Kuvendin e Kosovës dhe mund të ketë liderë partiakë të cilëve do t'u hakmerret injorimi i anëtarësisë. Kosova ka hyrë në një fazë të jostabilitetit politik, i cili, fatkeqësisht, nuk do të jetë afatshkurtër.

Afatgjatë do të jetë, prapë fatkeqësisht, polarizimi politik, helmi, kurthet, intrigat - të gjitha këto të shoqëruara edhe nga propaganda parapolitike.

ALFRED LELA

Ka një prirje të votave, deri tani, në favor të Edi Ramës. Një prirje që flet për humbjen e opozitës dhe për fitoren e qeverisë.

Ende mbetet e paqartë se si do të kapin finishin minipartitë e Shehajt, Lapaj-Shabanit dhe Qorit.

Çka duket qartë është se Tom Doshi me PSD do të jetë partia e tretë në Shqipëri, duke u bërë kingmaker. Edhe pse, siç duken gjasat, një kingmaker që nuk bën dot një mbret, pasi në asnjërin anë të spektrit nuk do të ketë nevojë për të për të bërë qeveri. Doshi mund të hyjë në punë vetëm nëse Rama i afrohet një shumice dërmuese me të cilën kërcënon të ndryshojë Kushtetutën.

Socialistët do të ndihen triumfalistë këto ditë dhe demokratët të dorëzuar. Nuk është e tepërt për të thënë se ka humbur Shqipëria në këtë mes. Jo se ka humbur PD-ASHM, por se në zgjedhje të tilla si të djeshmet, po kështu, do të humbte çdo koalicion, dhe fitorja mund të ishte vetëm e Edi Ramës.

Pse?

Manualet e politikës botërore nuk njohin ende një politikan që fiton pa program. Retorika e Ramës e ka shmangur ofertën dhe është përqendruar te një spekulim gjeopolitik, antarësimi në BE, i cili, së pari, është synim mbarëkombëtar-të gjitha partitë bien dakord te integrimi- por edhe nuk është në dorën e qeverisë. Vendimi për të merret, jo vetëm mbi kriteret e përmbushura ose jo nga Shqipëria, por edhe nga një konklavë

AFRIM KRASNIQI

Votimet mbaruan duke konfirmuar hendekun në sondazhe, – mazhoranca fitoi mandatin e katërt dhe për paradoks, më me shumë mandate sesa të gjitha mandatet e mëparshme. Statistikisht nuk ka surprizë, – PS ka thuar se të njëjtin numër votash si në tri zgjedhjet e mëparshme, duke pasur nivel mobilitetit të strukturës së vet patronazhiste në nivele 95%-98%, por ka rritje të numrit të mandateve për shkak se votat pro PD+LSI kanë rënë të ndjeshme në raport me zgjedhjet e kaluara.

Niveli i mobilitetit tek opozita varion midis 55%-60% e pamjaftueshme për të siguruar pjesëmarrjen në votim as të votuesve historikë të saj, dhe natyrisht, e pamundur të fitojë votat e pjesës së pavendosur, jo mbështetëse të qeverisë.

Aleanca me LSI (PL) nuk funksionoi, shumica e votave të saj klienteliste u rikthyen në PS ose kaluan në PSD, ndërkohë që votuesit asnjëherë zgjedhën partitë e reja.

NË ZGJEDHJE TË TILLA FITORJA MUND TË JETË VETËM E EDI RAMËS



e vështirë e shteteve antare të BE, secili prej tyre me fuqinë e vetos.

Nga ana tjetër, Rama ka ofruar një repertor me batuta, me fyerje dhe mujshari (bullizëm), por nuk është kjo tipologjia kryesore e fushatës së tij. KM e ka përdorur pa teklif, pa drojë, pa kufizim, makinerinë shtetërore në

shërbim të agjendës elektorale. Të qarta në krahun e tij kanë qenë edhe bandat, nga jugu në veri. Xhabafitët në oborrin e qendrës së votimit në Vorë dje, nuk janë shenjë e një Shqipërie normale, ata janë riciklim i një dramatizimi politik që është shpërfaqur sa e sa herë, sipas parimit 'synimi e justifikon mjetin'. Nëse gangot e Vorës

thonë se janë 'qytetarë', kujtoni pak rastin e Juges Çyrbjes, që u fut në listat e Ramës nga porosia e bandave të zonës.

Jo vetëm periferitë janë kriminalizuar dhe e kanë shtrembëruar realitetin elektorale. Kush ka parë TV dje është përballur me skena groteske dhe dra-

matike mu në zemër të Tiranës. Drejtorë të lartë të administrates, me kapuçë të zinj, barkmëdhenj të doganave, deputetë felinë të qeverisë, gra të ndërkyera etj., etj., u kapën në kamera tek vraponin, fshiheshin, skërmiteshin, kërcënonin ditën për diell. Rasti i zyrës elektorale ilegale të PS te Njësia 5 është shenja sipërfaqësore se zgjedhjet në Shqipëri nuk janë garë, nuk janë sfidë, nuk janë program, ato janë luftë për të mos e lëshuar pushtetin, qëllim në vetvete i pushtetit.


Në këtë kuptim mund të përsëritet se, me zgjedhje të tilla fitorja i shkon dhe do t'i shkojë Edi Ramës.

Ajo çka mbetet me ne edhe pas kësaj fitore/humbjeje është kthimi i këtyre farë zgjedhjeve në njëfarë forme të normalitetit. Kush e ruan ende fakultetin e turpit në ndërgjegje, ka patur zor dje nga skenat me protagonistë kryesorë njerëzit e administratës dhe bandat lokale të kthyer tashmë në pasuri kombëtare nga Edi Rama.

Fituesit mund të qeshen, por nuk po prodhojnë më shumë se një skërmitje në kurriz të Shqipërisë. Shpopullimi dhe kriminalizimi do mbeten, edhe pas 11 majit, dy sfida të mëdha kombëtare.

Edhe më shumë të tilla sepse, paradoksalisht apo jo, zgjedhjet i mori partia që normalizoi, si shpopullimin ashtu edhe kriminalizimin.

PS KRIJOI SISTEM PATRONAZHIZMI QË NJËSON PARTINË, SHTETIN, OLIGARKINË, INFORMALITETIN DHE 'TË FORTËT'



Natyrisht, t PS krijoi një sistem patronazhizmi që njëson partinë, shtetin, oligarkinë, informalitetin dhe "të fortët", praktikë antiligjore që PS e testoi edhe më 2017 dhe 2021. Në çdo rast referues të njëjtë në botën demokratike opozitat kanë pasur sukses kur reformohen, frymëzojnë me

ide, hapen ndaj prurjeve cilësore dhe luftojnë me kartat morale, katër cilësi që PD+ i refuzoi me arrogancë.

Zgjedhjet bëhen për të ofruar zgjidhje. 11 maji e humbi këtë shans. Ata që ishin konfirmuar vetveten dhe besnikët. Risitë janë minimale dhe jo

vendimmarrëse. Katër herë një parti ka pasur mbi 80 mandate, 1991, 1992, 1996 dhe 1997, vetëm në një rast ato prodhuan reforma dhe progres (1992), kur de facto nuk ishte votë partie, por votë për ndryshim sistemi.

Vazhdimi dihet: mazhoranca do shijojë mbipushtetin e pa shqetësuar, do të kemi dobësim të ndjeshëm të jetës parlamentare, të kontrollit e balancës së pushteteve, të rolit të institucioneve të pavarura dhe natyrisht, rënie të lirë të standardeve të demokracisë funksionale dhe shtetit të së drejtës. Opozita? Shih listën e mbyllur të Tiranës dhe e kuptojmë si do jetë, opozita që çdo qeveri do të donte të kishte.

Do kemi protesta, kontestime, show, marrëveshje të reja, kulla të reja, por jo dorëheqje dhe as llogaridhënie.

Drejtësia do hetojë ca raste fatkeqe të

individëve që u detyruan të fotografonin votën, por jo ata që urdhëruan fotografimin e votës dhe as sistemin korruptiv, i cili, duke cituar opozitën e 2009-2012, "vjedh Shqipërinë për të vjedhur vota dhe më pas vjedh vota për të vjedhur Shqipërinë".

Ata nuk ndryshuan këtë sistem korruptiv, thjesht e perfeksionuan atë.

Kur demokracia devijon, populizmi merr vendime, militantët kontrollojnë pushtetin dhe idetë moderatore refuzohen, është detyrë dhe përgjegjësi e pakicës, – zërave me integritet, të flasin, të veprojnë dhe të reagojnë më shumë, të refuzojnë "status quo" dhe establishmentin e korruptuar politik e të ushqejnë sa munden dije, kulturë e shpresë në vendin ku nga Kalimashi, Q.Murrizit, Elbasani dhe deri në Llogara gjendet e njëjta parullë domethënëse dhe konsensuale "mirë se erdhët në tunel".

#BreakingTheChains

Forest Gate Youth Club

Immigration advise

Sports & Dancing

Peer support

General info and support


Come Dine with Me



Join us


every Monday evening 6-9pm

 1 Woodford Road,
Forest Gate,
London, E7 0DH

 07494974957


Shpresa Programme

Inspiring hope & change



SHISHA BAR PËR SHITJE

- I HAPUR PREJ VITESH
- ME KLIENTELE TË GARANTUAR
- I PAJISUR ME TE GJITHA LIÇENSAT
- ÇMIMI SHUMË I ARSYESHËM
- PËR MË SHUMË INFO NA KONTAKTONI
- TEL: 07557565437



DW

Zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në Shqipëri gjetën jehonë në median gjermane, ku përmendet, se PS dhe Edi Rama shkojnë drejt një mandati të katërt. Por gjendet edhe një reflektim i situatës në Shqipëri.

Pas zgjedhjeve në Shqipëri media gjermanishtfolëse përmend gjasat që kryeministri, Edi Rama të shkojë drejt një mandati të katërt. Por reflektohet edhe mbi situatën aktuale në Shqipëri, ku theksohet, se megjithëse Edi Rama dhe Partia Socialiste shkojnë drejt fitores ata janë të kontestuar në politikën e brendshme.

Gazeta "Neue Zürcher Zeitung" nën titullin "Edi Rama do të jetë për herë të katërt kryetar qeverie i Shqipërisë -portret i një antikongformisti të përhershëm" nënvizon sot se nuk duhet të gënjehemi nga imazhi i Ramës si një i jashtëm në politikë. "Fituesi me gjasë i zgjedhjeve është një politikan i etur për pushtetin", shkruan NZZ. Andreas Ernst pasi përmend suksesin e Ramës si kryetar bashkie i Tiranës, i referohet ndryshimit të kryeqytetit dhe thekson se në këtë bum ndërtimi në Tiranë përqendrohet gjithçka shkon keq në Shqipëri.

"Ekonomia e tarave jep leje ndërtimi për të vetët dhe dhënia e tenderave varet nga lidhjet politike, paratë e zeza dhe kthimi i favoreve." NZZ hedh vështrimin edhe tek fitorja e pritshme e zgjedhjeve nga socialistët dhe thekson se "sistemi klientelist i lyer mirë i Ramës është njëri shpjegim për suksesin zgjedhor të socialistëve.

Shpjegimi tjetër është kundërshtari i tij, 81 vjeçari, Sali Berisha. Ndryshe nga Rama ai është një autokrat i tipit të vjetër, jo origjinal, kozmopolit apo sharmant." Më tej NZZ vëren mbi Edi Ramën, se "më së voni në vitin 2005, kur ai mori pushtetin në PS u bë e qartë, se ai para së gjithash është një

"SISTEMI KLIENTELIST I LYER MIRË I RAMËS NJËRI SHPJEGIM"



DW: SISTEMI KLIENTELIST I LYER MIRË I RAMËS, NJËRI SHPJEGIM PËR SUKSESIN ZGJEDHOR TË SOCIALISTËVE

politikan i etur për pushtetin, që në politikë njihet vetëm mik dhe armik." [...]Rama ngriti një aparat pushteti siç e njohin mjaft vende në rajon: Ai është kreu i një partie, që kontrollon administratën, gjykatat dhe mjaft media."

Në median gjermane, Rama portretizohet si vërtet proeuropian, artist jo konvencional që mirëpritet mjaft mirë në Bruksel, sepse politika është konform BE, por edhe mjaft i kontestuar. "Zgjedhje në Shqipëri: Sa autoritar është Edi Rama", pyet një nga radiot më të mëdha gjermane, "Dlf" në një kronikë të gjerë të fundjavës.

"Edi Rama është në BE një mik i mirëpritur, dhe duket se nga ana ideologjike dhe gjeopolitike qëndron i palëkundur në anën e Europës. Por kritikët i tremben asaj se sukseset e Shqipërisë për temat si shteti ligjor dhe demokracia janë suksese vetëm në letër, dhe se vendi nuk është i gati për anëtarësim në BE. Kjo ka të bëjë edhe me Edi Ramën që tregon tipare autoritare."

"Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri: Vendi i NATO-s në rrugën e anëtarësimit në BE" ky është titulli me të cilin "Frankfurter Rundschau" i kushton vëmendje zgjedhjeve në Shqipëri

duke theksuar se kryeministri në detyrë mund të marrë mandatin e tij të katërt. Por pavarësisht ambicieve për në BE-së, politika e tij e brendshme është e kontestuar. "Sipas komisionit zgjedhor, rezultatet e para duhet të dalin të martën. Votimi i së dielës shihet si një test i rëndësishëm i disponimit në rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE."

Gazeta "Zeit" i kushton vëmendje rezultateve paszgjedhore. "Pas zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri të dielën, po ravijëzohet një fitore e Partisë Socialiste (PS) të kryeministrit Edi Rama.

Pas numërimit të më pak se një të

tretës së votave, rreth 53 për qind e tyre shkuan për PS, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. [...]

Rama, 60 vjeçar, ka drejtuar PS që nga viti 2005 dhe kërkon një mandat të katërt radhazi si kryeministër. Gjatë fushatës elektorale ai deklaroi se do të vazhdojë përpjekjet për anëtarësim në BE në vitin 2030, në mënyrë që të gjithë shqiptarët të përfitojnë nga 'të njëjtat të drejta si qytetarët e vendeve të tjera evropiane'.

Rama është akuzuar vazhdimisht nga opozita për kontakte me krimin e organizuar, gjë që Rama e mohon."/DW

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazonin biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



MENTOR KIKIA

A e përdori PS pushtetin, infrastrukturën, administratën e qeverisë së saj për të “bërë” vota? Padyshim që po!

A e ka ndikuar rezultatin e zgjedhjeve makineria e patronazhimit, me njerëz që të dinë edhe zorrët e barkut, kush je, me kë je, ku të punon gruaja, burri, fisi e farefisi, ku të pikon çatia etj? Padyshim që po!

Opozita mund të rendisë edhe nja 20 arsyse të tjera për humbjen e zgjedhjeve...

Por....

A e votuan PS-në ata fshatarët që kanë shkullur pemët apo braktisur fermat e tyre me mollë e pjeshkë, e shkojnë punojnë në fermat e grekëve, sepse këtu nuk kanë ku ta shesin prodhimin?

A e votuan PS-në ata që derdhin qumështin në rrugë, sepse tregun e ka pushtuar qumështi që vjen nga Serbia, pasi prodhimi vendas nuk mbrohet?

A e votuan PS-në ata që protestojnë, duke hedhur domate e kastraveca nëpër rrugë, sepse prodhimet e tyre



nuk shiten për shkak të koston së lartë, pasi subvencionet janë shumë të ulëta?

A e votuan PS-në ata pensionistët “e gjorë”, që për një shpërblim qesharak dergjen nëpër radhë të gjata e na bëjnë ti mëshirojmë?

A e votuan PS-në mijëra të moshuar që mezi presin paratë e fëmijëve nga jashtë për të blerë ilaçet e për të paguar dritat?

A e votuan PS-në ata prindër që kanë mbetur të vetëm nëpër shtëpi, lagje e fshatra ku nuk dëgjohej prej vitesh zëra fëmijësh?

A e votuan PS-në ata që enden dyerve të spitaleve pa ilaçe e qajnë para kamerave se po vdesin, sepse nuk bëjnë dot as kimioterapinë?

A e votuan PS-në qindra mijëra njerëz, që çdo ditë i mbushin serbatorët e makinave me karburantin që

kushton më shtrenjtë se në Gjermani, Itali, Francë etj?

A e votuan PS-në ata që revoltohen në rrjet, sa herë duhet të paguajnë tarifë kur kalojnë edhe në rrugët e ndërtuara me taksat e tyre?

A e votuan PS-në mijëra e mijëra të tjerë, që sa herë lexojnë e dëgjojnë lajme për aferat qindra miliona Euro të autostradave, tuneleve, TEC-eve lundruese, konçensioneve të sterilizimit, inceneratorëve, investitorëve strategjikë..., pra sa herë dëgjojnë nga këto, shajnë e mallkojnë: Mos u ngopshi, mos i hëngshi...

A e votuan ata, që kur lexojnë lajme me arrestimet e SPAK-ut, për ministra, deputetë e zyrtarë të tjerë thonë: Inshallah këmbën zvarrë. Atje shkofshi të gjithë ju që na vidhni...

E di që do të më thoni: Po kë të votojmë? Të rikthejmë sërish Berishën? E drejtë! As unë nuk e mbështes rikthimin e Berishës. Por shporta kishte më shumë se dy produkte kësaj radhe, për ta ngritur zërin e revoltës. Nëse do të kishte

revoltë.

Miq!

Të bëhesh palë me pushtetin është një gjë komode dhe fitimprurëse në këtë vend. Por unë kam zgjedhur të jem një zë kritik, pavarësisht kush ka qenë në pushtet. Sepse mendoj se të jesh kritik i shërben më mirë vendit, shoqërisë dhe demokracisë. Por, përse duhet që unë, apo disa të tjerë si puna ime, ti kërkojnë llogari qeverisë për naftën e fermerëve, për pensionistët, për mungesën e ilaçeve, për korrupsionin, për taksat e larta, për çmimin e karburantit e për të tjera probleme që prekin njerëzit drejtëpërdrejtë, kur vetë ata nuk shqetësohen? Madje duken edhe të lumtur.

Ndaj unë kam vendosur ta respektoj vendimin e "sovranit" tonë. Do ta mbështes zgjedhjen e tij. Sepse “sovrani” nuk kritikohet kurrë, ai di gjithmonë çfarë bën.


Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është gati për të fituar mandatin e katërt radhazi në zgjedhjet parlamentare, pasi zhvilloi një fushatë të fokusuar në anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian deri në vitin 2030.

Numërimet paraprake dhe exit poll-et e së hënës tregojnë se Partia Socialiste e Ramës do të ruajë shumicën në parlament, përpara Partisë Demokratike të djathtë, të udhëhequr nga ish-kryeministri Sali Berisha, i cili provoi një rikthim politik të stilizuar sipas lëvizjes MAGA të Donald Trump.

Rezultatet përfundimtare priten të martën. Sipas një exit poll-i të publikuar nga Albanian Post, socialistët priten të sigurojnë rreth 52% të votave, ndërsa Partia Demokratike rreth 38%, me pjesën tjetër të ndarë mes disa partive të vogla. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 42.2%, edhe pse për herë të parë u lejua diasporës të votonte.

Shumica parlamentare e Ramës, edhe pse nën pragun e dy të tretave të nevojshme për ndryshime kushtetuese, do të jetë vendimtare për të përmbushur reformat e kërkuara për anëtarësimin në BE. Shqipëria u anëtarësua në NATO në vitin 2009, por ka pasur vështirësi për të përshpejtuar ritmin drejt Bashkimit Europian.

FT / RAMA FITON MANDATIN E KATËRT: RREZIKOHET KRIJIMI I NJË PLURALIZMI KOZMETIK



“Asgjë dhe askush nuk do të mund të ndalë fatin europian të shqiptarëve,” tha Rama gjatë fundjavës, duke përmendur se vendi ka hapur kapituj negociues në 24 nga 35 fushat me Komisionin Europian.

Por disa vëzhgues paralajmëruan se, ndërsa Rama — ish-basketbollist dhe piktor që u kthye në politikan — hyn në mandatin e katërt të tij, për herë të parë në historinë post-komuniste të Shqipërisë, ekziston rreziku i forcimit të mëtejshëm të pushtetit të tij.

“Kemi një sheriff të vjetër me edhe më shumë muskuj — një lloj paradoksi, kur në fakt duhet të forcohen institucionet e pavarura,” tha Lutfi Dervishi, analist i pavarur dhe ish-drejtor i Transparency International në Shqipëri.

“Shqipëria duhet të përpiqet të mbajë gjallë pluralizmin politik,” shtoi ai, duke kujtuar se Rama erdhi në pushtet për herë të parë në vitin 2013 përmes një koalicioni. “Me çdo mandat, ai bëhet më i fortë... Rrezikojmë të kemi pluralizëm kozmetik.”

Ashtu si në disa vende të tjera të

Ballkanit Perëndimor, mospërbushja e pritshmërive në luftën kundër korrupsionit ka penguar përparimin më të shpejtë drejt BE-së. Rama, që ndodhet në vijën e parë të politikës prej dy dekadash, ka pasur vështirësi në frenimin e korrupsionit në administratën e tij dhe në reduktimin e ndikimit të grupeve kriminale të fuqishme.

Rivali i vetëm i Ramës në këto zgjedhje ishte edhe më pak “freski” në skenën politike, pavarësisht sloganit të tij “Ta Bëjmë Shqipërinë Madhështore Sërish”: Sali Berisha, 80 vjeç, ish-president i Shqipërisë, i cili është i ndaluar nga SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar për shkak të dyshimeve për korrupsion — të cilat ai i mohon.

“Jam i zhgënjyer me rezultatet,” tha Edval Zoto, konsulent nga kompania Integr Partners në Tiranë. “Prisja më shumë mbështetje për nisma të reja, me shpresën se do të ofronin një opozitë më serioze ndaj hegjemonisë së socialistëve.”

Shqipëria ka pasur vështirësi në

frenimin e emigracionit, i nxitur nga varfëria dhe korrupsioni i vazhdueshëm. Eksodi ka qenë sfidë për autoritetet britanike, të cilat përpiqen të ndalin kalimet ilegale përmes Kanalit të La Manshit.

Megjithatë, Rama ka mbetur një aleat besnik i SHBA-së dhe BE-së, duke krijuar një marrëdhënie të ngushtë me Kryeministren italiane Giorgia Meloni, pasi ofroi të strehojë qendra të ndalimit për migrantët italianë në territorin shqiptar.

Ai gjithashtu ka treguar gatishmëri për të bërë marrëveshje biznesi me figura të larta të afërta me Trump, përfshirë Jared Kushner, dhëndrin e ish-presidentit amerikan, i cili ka plane për të zhvilluar pjesë të mëdha të bregdetit shqiptar.

“Ai ka interes të krijojë miq të fuqishëm në BE dhe më tej,” tha Dervishi. “Ndryshe nga liderët e tjerë të Ballkanit, Rama ka një luks: askush nuk e vë në dyshim orientimin perëndimor të Shqipërisë.”

THE IRISH TIMES

Jam në një pazar qilimash në Pazarin e Vjetër në qytetin malor të Krujës në Shqipëri duke blerë një mbulesë tavoline të bukur, të punuar me dorë në stilin tradicional të Shqipërisë dhe një grusht me mbështetëse tavoline të thurura, të gjitha për më pak se 40 euro, shkruan Aoife McElwain për gazetën më të madhe irlandeze "The Irish Times".

"Kur nuk negocioj çmimin me burrin dhe gruan që kanë këtë dyqan, ata duken të hutuar. Ata më bëjnë gjeste drejt një tasi plot me hide, një frut që duket si ulli, por me shije molle e përzier me hurmë.

I falënderoj dhe marr një; ata tundi kokën dhe hedhin 250 gramë hide në një qese dhe ma japin të gjithën. Ata psherëtimin të kënaqur, të kënaqur që po largohem me paratë e mia.

Tri gjëra më joshin përsëri në këtë vend magjepsës në Ballkan: historia, ushqimi dhe njerëzit.

Ky është një vend me 2,6 milionë shqiptarë, një përzjerje myslimanësh dhe të krishterësh që kanë një histori të gjatë bashkëjetese paqësore.

Shqipëria, e njohur edhe si Albania, kufizohet me Greqinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, me një vijë bregdetare që përfaton detin Adriatik në veri dhe detin Jon në jug.

Është ky bregdet jugor që mori rëndësi virale në verën e vitit 2023, kur TikTokeri @thetravelmum e quajti plazhin ishullor të Ksamilit, i arritshëm me traget nga Korfuzi në Greqi, "Maldivet e Evropës".

Shumë faqe interneti e morën atë dhe papritmas dukej se të gjithë po flisnin për Shqipërinë dhe vijën e saj bregdetare në stilin e Rivierës si destinacionin e ri të Instagram-it.

Por, Shqipëria është shumë më tepër sesa një krahasim me një destinacion tjetër; është një vend pushimesh për dashamirësit e historisë, kuriozët dhe mendjehapurit.

Janë muralet dhe xhamitë e kryeqytetit, Tiranës; fakti që kryeministri i tyre, Edi Rama, është gjithashtu një artist dhe piktor; qentë endacakë dhe bamirësitë e kafshëve që kujdesen për ta; ecja në Alpet Shqiptare; bluja mbresëlënëse e Rezervuarit të Bovillës; qilimat e punuar me dorë në Pazarin e Vjetër në Krujë; ushqimet e detit në Vlorë; arkitektura e qytetit kodrinor të Beratit, pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s; uji kristalor dhe plazhet me guralecë në Dhërmi dhe byreku, salca e kosit dhe rakia kudo.

Dhe ëmbëlsirat. Oh, ëmbëlsirat.

GAZETA IRLANDEZE: SHQIPËRIA ËSHTË QUAJTUR MALDIVET E EVROPËS, POR KA SHUMË MË TEPËR NË KËTË VEND MAGJEPSËS

Shqiptarët janë pushtuar, pushtuar dhe kolonizuar gjatë gjithë historisë, më së shumti nga Perandoria Romake bizantine dhe Perandoria Osmane (për 500 vjet), fashistët italianë dhe nazistët.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945, revolucionari komunist Enver Hoxha dhe regjimi i tij komunist thellësisht izolacionist erdhën në pushtet dhe qëndruan atje deri në vdekjen e tij, në vitin 1985.

Gjatë diktaturës së Hoxhës, Shqipëria ishte një shtet i izoluar dhe i mbyllur. Askush nuk hynte, askush nuk dilte. Udhëtimi brenda vendit për shqiptarët ishte i kufizuar dhe njerëzit që flisnin kundër regjimit thjesht eliminoheshin.

Një trashëgimi shumë vizuale e këtij regjimi janë mijëra bunkerët që gjenden të shpërndarë në të gjithë vendin – ata u projektuan për njerëzit për të mbrojtur vendin nga sulmi bërthamor, të cilin Hoxha e ndjente të pashmangshëm.

Ai ndërtoi një bunker gjigant sekret nëntokësor për veten e tij, familjen e tij dhe elitën politike.

Ndodhet në veri të qendrës së qytetit të Tiranës, tani një muze i quajtur Bunk'Art, i cili është një vizitë e rekomanduar për të kuptuar regjimin, megjithëse kini kujdes – është i frikshëm.


Për një pasqyrë të mirëfilltë të qytetit të Tiranës, mund të merrni një teleferik deri në majë të malit të Dajtit në teleferikun "Dajti Ekspres" ose vetëm një udhëtim i shkurtër me makinë nga Muzeu Bunk'Art.

Kushton 14 euro për person dhe zgjat rreth 15 minuta në çdo drejtim.

Në një ditë të kthjellët mund të shihni të gjithë Tiranën dhe deri në vijën bregdetare deri në qytetin port të Durësit.

Në Turin Falas më Këmbë të Tiranës, të udhëhequr nga guida jonë e re informuese dhe simpatike, Aurora, ne vizitojmë sheshin "Skënderbej", Xhaminë e Et'hem Beut, Piramidën, statujën e Nënë Terezës në Katedralen Ortodokse dhe shtëpinë në qendër të qytetit ku jetoi Hoxha.

E pyeta Aurorën se si është të jesh një e re në Tiranë; ajo thotë se ndihet e



sigurt për të ecur kudo në çdo kohë dhe shqetësohet vetëm nëse do të jetë në gjendje të përballojë qiranë e saj në qytet për shkak të inflacionit të kohëve të fundit.

Përgjatë shtegut të turit më këmbë, kalojmë disa nga bunkerët e Hoxhës dhe një cope të Murit të Berlinit, një dhuratë nga populli gjerman për shqiptarët, që tani ekspozohet në qendër të Tiranës.

"Populli shqiptar është ende i prekur nga ajo që ndodhi gjatë asaj kohe në vendin tonë", thotë Aurora.

"Prindërit e mi nuk ishin pro sistemit dhe ndihen shumë më mirë tani që kanë më shumë mundësi pune, liri zgjedhjeje, liri fjale dhe liri për t'u zhvendosur në qytete të tjera brenda Shqipërisë dhe në vende jashtë Shqipërisë", shton ajo.

Rruga e vështirë e tranzicionit nga regjimi komunist në demokraci përshkruhet bukur nga akademikja shqiptare Lea Ypi në librin e saj të vitit 2021 "Të lirë".

Lea ishte 10 vjeçe në vitin 1989 kur ra Perdja e Hekurt dhe ajo përshkruan kthesën që iu desh të bënte si vajzë e vogël kur gjithçka që ishte rritur të besonte doli të ishte aspak e vërteta e plotë. Është një libër që duhet lexuar para udhëtimit tuaj.

Nëse nuk keni oreks për historinë, kultura e ushqimit është padyshim e shijshme. Ushqimi, sigurisht, mund të jetë një shprehje krijuese për identitetin kombëtar, dhe shqiptarët e shprehin të tyren përmes një brumi të mrekullueshëm rrethor të mbushur me djathë, spinaq ose mish, i njohur si byrek, një kos të trashë të kripur të quajtur salcë kosi dhe një pije alkoolike frutash që të lë pa fjalë dhe që quhet raki.

Të hash jashtë në restorante dhe kafene është e përbalueshme për vendasit dhe është një pjesë e madhe e kulturës dhe një nga gëzimet e vizitës sime.

Në restorantin "Era" mund të shijoni Shqipërinë dhe Ballkanin.

Gjatë vaktit tonë kemi bukë misri krokante me ajkë dhe djathë dhe; qofte me fëstëkë dhe kos; "Tavë Kosi e Famshme e Elbasanit" (ky është emri i vërtetë i pjatës në menu); një salsicë pikante të Kosovës dhe pite. Rezervimi është i domosdoshëm ose përgatituni të mban radhën.

Brooklyn-i global ka mbërritur edhe në Tiranë, me kafene të specializuara në modë si "Karamel" që po shfaqen, por ka edhe kafene si "Radio Bar" dhe "Vena", që janë padyshim më interesante dhe më të krahasueshme me kafenet e Berlinit nëse kërkonit një kornizë referimi. Ekziston një skenë diskrete LGBTQ+; "Radio Bar" dhe "Bunker 1944" konsiderohen baret më të mira miqësore për homoseksualët në qytet.

Në "Hana's Corner Cafe" do të gjeni ëmbëlsirat e famshme me kanellë apo byrek të bërë në shtëpi. Kjo kafene shërben edhe si një hapësirë komunitare që ofron degustime verërash, lexim poezish dhe takime të përkohshme.

Ne takojmë legjendën vendase Geri, një grua të vogël që bën makaronat dhe byrekët më të mirë të freskët në qytet, sipas vendasve, në dyqanin e saj të pastave të freskëta për të marrë me vete, "Pasta Fresca" në rrugën "Komuna e Parisit".

Blini pak lazanjë të freskët për të ngrënë në apartamentin ose hotelin tuaj ose merrni një byrek për ta marrë

në shtëpi në bagazhin tuaj të udhëtimit.

Akullorja në "La Nocciola" është e jashtëzakonshme, por janë ëmbëlsirat në Tiranë ato që vërtet kënaqin, me shumicën e furrave të bukës që qëndrojnë të hapura nga ora 07:00 deri në 23:00. "Nefeli", një furrë buke me tre lokacione në qytet, ishte një nga të preferuarat tona; biskotat me fëstëkë, torta e kuqe si prej kadifeje, byrek, torta me portokall dhe bajame dhe trileçe – një ëmbëlsirë me karamel qumështi e famshme në Ballkan – dhe ëmbëlsira dhe sanduiçe të kripura për t'i ngrënë në shtëpi ose për t'i marrë me vete.

Për një udhëtim në bregdet, shkoni në jug. Në Dhërmi, ku vendasit shkojnë për pushimet e tyre verore, do të gjeni plazhe me ujë të kaltër deti, plazhe me guralecë dhe një pamje të Korfuzit nga shezlongu juaj.

Në veri do të gjeni Alpet Shqiptare, të njohura edhe si Bjeshkët e Namuna. Nëse nuk mund të shkoni në Parkun Kombëtar të Thethit për një aventurë të mirëfilltë ecjeje në këmbë, Rezervuari i Bovillës ofron një gllënjë të peizazhit natyror mahnitës të Shqipërisë.

Ky rezervuar i krijuar nga njeriu është pjesë e Parkut Kombëtar të Malit Dajt, dhe ka ture që ju çojnë në fillim të shtegut të shkurtër dhe të njohur, për një aluzion të peizazhit malor që mbretëron mbi Tiranë, pa pasur nevojë të udhëtoni shumë larg kryeqytetit.

Aty pranë, në qytetin e Krujës, ndodhet Pazarit i Derexhikut. Ndihet sikur është ndërtuar me porosi për turistët, por është i bukur, dhe vazhdoni të ecni përgjatë rrugës kryesore drejt Xhamisë së Pazarit, e ndërtuar në vitin 1533, dhe dyqani i fundit në të djathtë tuaj, i cili ka një makinë të mirëfilltë endeje brenda.

Merrni me vete një valixhe shtesë për qilimat me madhësi të plotë. Janë mahnitës.

Nëse po kërkonit një vend të njohur për të qëndruar në Tiranë, "Marriott" dhe "Radisson" ofrojnë dhoma që fillojnë nga rreth 150 euro për natë ose provoni "Artistic Tirana Blloku" që të jeni në zonën e Bllokut, plot me kafene, bare dhe dyqane të bukura.

"Ryanair" fluturon nga Dublini në Tiranë, me një ndalesë në Stokholm. Si alternativë, fluturoni për në Luton dhe pastaj nga Lutoni në Tiranë me "Wizz Air".

PSE U RRRIT EDI RAMA?

ANDI BUSHATI

Rezultati marramendës i Edi Ramës, më i madh se i të gjitha herëve kur ai ka kandiduar si lider i PS-së, ngre një pikpyetje themelore: si ka mundësi që sa më shumë vërtetohen vjedhjet e paimagjinueshme të bandës në pushtet, aq më tepër asaj i rriten votat? Mos vallë ne jemi një popull i prekur nga sindroma e Sokholmit, që i adhurojmë torturuesit tanë? Mos shqiptarëve i pëlqen të jetojnë pa minimum jetik, pa ujë 24 orë, pa pensione dinjitoze? Mos vallë ata ndihen rehat me pushtetarët që i gënenjnë për premtimet që u japin? Apo ndoshta Koka, Beqaj, Tahiri, Ahmetaj, Bllako, Veliq nuk janë personazhet e urreyer që i kanë futur dorën në xhep, por heronjtë e pamundur, si të cillët ata ëndërrojnë të bëhen?

Të gjithë këto pyetje burojnë natyrshëm kur dikush përpiqet ti largohet zhurmënjës së denoncimit të incidenteve të vogla elektorale dhe sherrit për ndonjë kuti të kontestuar votash.

Përmbi këto cic mice të momentit ka një dilemë të thellë që kërkon spjegim. Si mund të arsyetohet se në vitin 2013, kur ishte i virgjër e pa mëkate pushteti, Rama mori shumë më pak? Pse mandatin e parë (2017) që e mbylli pa ndonjë skandal të madh dhe të dytin (2021) që gjithësesi nuk qe aq i njollosur sa sot, doli më keq se këtë 11 maj? Pra, si ka mundësi, që sa më i madh mëkati aq më i fryrë rezultati?

Të gjithë mbështetësit e pushtetit që kërkojnë të përligjin këtë paradoks, i shmangen fajësimit të një populli që ka humbur reflektet e reagimit demokratik. Duke dashur të jenë politikisht korrektë ata kanë gjetur një tjetër alibi për të arsyetuar këtë anomali.

Ata thonë se vërtet gjërat kanë degraduar, por për këtë faji është i një opozite që nuk përbën dot alternativë. I një Berishë që e ka kapur partinë dhe e përdor për interesat e veta personale. I ca zyrtarëve të rëndomtë që nuk arrijnë të frymëzojnë. I ish pushtetarëve të cilëve elektorati nuk u a jep dot më një shanc të dytë për të nusëruar sërish. Pra jo se Rama është më i mirë, por se fatkeqësisht nuk ka më të mirë sesa ai.

Por, nëse kjo alibi e sforcuar ka mundur të mbijetojë, si ushqim për budallenjtë për gati 12 vite, këtë radhë, pas këtyre zgjedhjeve, ajo nuk pi më ujë.

Pse? Le ta mendojmë me qetësi. Le ti pranojmë argumentat e të gjithë atyre që flasin për Berishën e plakur dhe të pabesueshëm. Le ti marrim të mirëqena edhe akuzat për një opozitë pa moral, që mbron gjithashtu interesat e oligarkisë dhe prandaj e ka humbur mbështetjen e publikut. Le të



bindemi për një PD që nuk rinovohet dot dhe që e ka të vështirë të prodhojë ide të reja.

Por, sërish kjo fabul nuk funksionon. Sepse në këto zgjedhje, ndryshe nga të gjitha të tjerat para tyre oferta opozitare ishte e plotë.

Dikujt që si pëlqente PD-ja, por ishte i djathtë, mund të votonte Mundësinë e Agron Shehajit, që përveçse superliberale ishte dhe e pakorruptuar, me një fushatë moderne dhe me djem e vajza të që s'kishin të sharë.

Ata që për bindje nuk e çonin dot votën djathtas, kishin një alternativë të mrekullueshme social demokrate, si Lëvizja Bashkë e Arlind Qorit, me aktivistë të spikatur në mbrojtje të kauzave qytetare dhe me një klithmë të vazhdueshme për barazi shoqërore.

Kush i trembej traumave që riskojnë të shkaktojnë ideologjitë mund ta çonte votën e protestës tek çifti Lapaj-Shabani, thjesht sa për të konfirmuar se nuk bie dakord me mënyrën se si po shkojnë gjërat në Shqipëri.

Por jo, pavarësisht se oferta opozitare ishte këtë radhë më e larmishme sesa

kurrë, Rama u rrit edhe më shumë. Bashkë me të u konfirmua edhe PSD e Tom Doshit, që përdor në niniaturë të njëjtën teknologji për mbledhjen e votës. Pra mjafton kaq për të vërtetuar se fabula sipas të cilës “rilindja fiton pasi nuk ka alternativë”, është një ushqim bajat për budallej. Megjithëse mundësia për të shprehur votën kundër këtij pushteti kësaj here ishte e pamatë, ai doli, përsëri, më i fortë se më parë.

Natyrisht që kjo anomali e ka një arsye. Ajo nuk ka të bëjë aspak me dobësinë e opozitës berishiste, por me të vërtetën e madhe se në 2025-ën pre e vjedhjes nuk ra vetëm PD-ja, por barabar me të edhe Arlind Qori, Agron Shehaj e Adriatik Lapaj. Kur thuhet kjo nuk duhet imagjinuar rrëmbimi i thjeshtë i votave duke thyer kunitë.

Jo, jo, manipulimi është më i madh. Ai ka të bëjë me prishjen e rregullave të lojës dhe shkallmimin e çdo premise demokratike që mundëson një garë të barabartë e të ndershme.

Në këto zgjedhje dështuan të gjitha ato kundërpushtete që duhet të ruajnë ekuilibrin midis palëve. Në mënyrë

qesharake u baltos SPAK- që me teatrin e Task Forcës së vet, sapo i “konfirmoi” shqiptarëve se në Shëpipëri nuk ka vjedhje, blerje apo trafikim të votës. Po të shohësh si u shfry tollumbacja e Dumanit, i cili u bë konfirmuesi i parë i këtij rezultati marramendës, madje para OSBE-ODHIR-it, e kupton më mirë këtë.

Një tjetër pushtet, që në një demokraci reale duhet të luajë rolin e watchdog u zvenit edhe më shumë këtë fushatë. Kësaj here ndodhi e paimagjinueshmja. U mbyll një garë elektorale ku nuk u organizua asnjë debat televiziv, apo ku nuk u bë një emision i plotë investigativ me temën më bazike: “Si është qeverisur vendi këto katër vite”. Cila qeveri e një vendi demokratik do ta kishte ëndërruar një luks të tillë? Cili autokrat nuk do ishte trajtuar po kështu?

Le të marrim një shembull. Agron Shehaj falë financave të veta të bollshme pati privilegjin e një trajtimi miqësor mediatik. Atij vetë dhe njëzëzve të tij të afërt iu bënë intervista të buta dhe portrete dashmërisë. Por kurrë, asnjëherë, kjo zëmërgjerësi nuk u shtri deri tek denoncimet që ai ka bërë kundër skandaleve të qev-

erisë, për ata që vdesin për mungesë ilarësh, për investitorët strategjikë, për koncesionet e rugëve. Pra ata që kujtojnë se ai qe i privilegjuar gabohen. Ai ka qenë njësoj i censuruar, sepse ai u lejua nga mediat të ishte trendy por nuk u pranua si opozitar. Pasi në këtë vend të merresh me qeverinë është tabu.

Kjo mund të shërbejë si një nga qindra mijëra fabulat se përse megjithëse ka shumë ofertë opozitare një pushtet që keqeveris, duke qenë njëkohësisht grabitës dhe arrogant, vijon të rritet.

Fabula është e thjeshtë: sepse gara e ndershme dhe e barabartë ka vdekur. Po ti shtosh dështimit të pushteteve të tjera, si drejtësisë dhe mediave edhe fuqinë e bandave kriminale për të imiduar zgjedhësit, financimin e blerjes së votës me para të zeza, kthimin e administratës në ushtri partiake, ashtu sukurse pamë në video në zyrën e deputetit Braçe e gjitha bëhet më e plotë.

Pikërisht aty merr përgjigje dhe dilema se si ka mundësi që Rama, sa më shumë diskreditohet si kleptokrat, aq më shumë rritet me vota: arsyeja nuk është se s'kemi opozit(ë)ja, por se s'kemi demokraci.

RAPORTI I OSBE-ODIHR/ MEDIAT NË SHQIPËRI, BASHKËPUNTORET E PUSHTETIT

Në raportin paraprak që ka përgatitur misioni vëzhgues i OSBE-ODIHR për votimin e 11 Majit, gjendja e medias në Shqipëri vjen përmes një përshkrimi ku është lënë mënjanë gjuha diplomatike dhe organet mediatike rezultojnë të jenë bashkëpunoret kryesore të pushtetit që e thelloi rezultatin krahasur me 4 vite më parë.

Si në konferencën e drejtuesve të misionit të vëzhgimit, ashtu edhe në dokumentin që përbën raportin paraprak të 11 Majit gjen frazat standarde që e përcaktojnë ditën e zgjedhjeve si një “ditë të qetë” dhe ku flitet për një “proces të mirëmenaxhuar” votimi, por më tej, vëzhguesit qartësisht çmontojnë një nga shtyllat më të kalbura të demokracisë shqiptare; mediat.

Në fjalën e kreu i misionit të OSBE-së në vendin tonë, Lamberto Zanier e qartësoi se çështja e situatës mediatike është një problem serioz i renditur me ndikim direkt në votën e qytetarëve.

“Sa i përket medias folem me shumë gazetarë, redaktorë dhe përfaqësues të institucioneve të tjera. Për të plotësuar edhe konstatimet tona ne bëmë edhe një monitorim të zgjeruar të medias. Dy partive politike iu dha thuajse dy herë më shumë kohë se partive të tjera dhe dy partitë e mëdha ishin ata që dominuan edicionet informative. Pati probleme me integritetin e mbulimit.

U pa se kishte materiale dhe filmime të ofruara nga vetë partitë politike dhe jo nga gazetarët. Për fat të keq monitorimi dhe raportimi nga AMA tregojnë se ishte i pamjaftueshëm gjë që përbën shqetësim për pavarësinë e kandidatëve” tha Zanier.

Ndërkohë sipas koordinatores speciale të OSBE, Farah Karimi, shqetësim në raportimin e fushatës ishin lajmet e gatshme që kishin si burim dy partitë e mëdha politike. “Përqëndrimi i pronësisë së medias minoi pluralizmin e burimeve infor-



mative dhe krijoi autocensurë mes gazetarëve dhe dy partitë kryesore ishin ato që dominuan burimin e lajmeve duke ua bërë të pamundur zgjedhësve të bënin një zgjedhje të mirëinformuar” u shpreh Farah Karimi.

Problematika e raportimit mediatik në vendin tonë u ngrit edhe nga Michal Gahler, përfaqësues i delegacionit të vëzhgimit nga Parlamenti European, i cili e quajti çështjen e medias një “problem madhor” që nuk siguronte kushte të barabarta në garën e partive. “Financimi jotransparent vazhdon të jetë një proces shqetësues, influencimi i pronarëve apo i politikanëve në linjën editoriale të medias, mungesa e një raportimi të pavarur, refuzimi i liderëve politikë për të pasur një debat ballë për ballë dhe rreshtimi i një numri të madh organesh mediatike politikisht e kufizon mundësinë e qytetarëve për informacione objektive.

Kështu, qytetarët nuk kanë mundësi të bëjnë zgjedhje të informuara” u shpreh Gahler.

Raporti i OSBE/ODHIR nxin mediat në Shqipëri

Raporti paraprak i OSBE/ODHIR pati konstatime të drejtpërdrejta, që nuk i kursen detajet për mënyrën se si informacioni kontrollohet dhe manipulohet sistematikisht në Shqipëri.

Sipas vëzhguesve, lajmet shpesh prodhohen nga vetë partitë politike dhe transmetohen nga mediat si “lajme të pavarura”, pa asnjë etiketë dhe pa asnjë filtër editorial.

“Materialet dhe filmimet e fushatës u ofruan nga partitë politike dhe u transmetuan nga televizionet pa u shënuar si të tilla, siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor, dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mori asnjë masë për të adresuar këtë praktikë” thuhet në ra-

port.

Ky fenomen i transmetimit pa filtër të materialeve që vijnë nga zyrat e shypit nuk është rastësi. Gazetaria investigative është në grahamat e fundit, ndërsa pjesa më e madhe e mediave jeton nga kontratat publike dhe reklamën qeveritare.

Raporti shënon qartë se “Pavarësia, diversiteti dhe integriteti i lajmeve në dispozicion të votuesve janë dëmtuar nga varësia e shumicës së mediave nga financimi jotransparent nga interesa politike dhe biznesi, shpesh të mbështetura nga kontrata qeveritare”.

“Përqëndrimi i pronësisë së medias më tej minon pluralizmin e burimeve të lajmeve, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Sipas disa bashkëbiseduesve të ODIHR EOM, pronësia e disa prej shtëpive më të mëdha të shitjes së reklamave nga interesa politike pengon shpërndarjen e drejtë të të ardhurave nga reklamata, ndërsa mungesa e matjes së besueshme të audiencës pengon shpërndarjen transparente dhe të përgjegjshme të reklamave publike” shkruhet në raport.

Me pak fjalë në Shqipëri, qytetarët nuk morën dot informacion objektiv, pasi siç vë në dukje OSBE/ODHIR në raportin paraprak: “Shumica dërmuese e mediave perceptohen të jenë të lidhura me partinë në pushtet.”

Dhe ky perceptim nuk është pa baza. Të dhënat financiare të cituara në raport flasin vetë. Sipas BIRN, në vitin 2023, Top Channel dhe TV Klan kapën 64% të tregut televiziv. I vetmi kanal pranë opozitës, Syri TV, përbënte vetëm 1.7% të të ardhurave të tregut televiziv dhe pësoi rënie me 22% krahasuar me një vit më parë.

Pafuqia e opozitës me mediat e ka-

pura

Partia Demokratike e drejtuar nga Sali Berisha nuk ruajti dot një distancë higjenike nga mediat e kapura nga qeveria Rama.

Kur ishte në arrest shtëpie, Berisha bëri disa përpjekje për ta denoncuar propagandën dhe i përcaktoi televizionet e mëdha si “teleturizmi”, por kjo nuk zgjati shumë, pasi e gjeti shpejt gjuhën e përbashkët dhe i vizitoi plot dëshirë studiot kryesore në mbyllje të fushatës elektorale.

Partitë e tjera në opozitë, me përjashtim të Lëvizja Bashkë të Arlind Qorit, shpresuan se me ndonjë marrëveshje të heshtur, do të shfaqeshin më shpesh në ekrane duke përfutur nga ky nder që po u bëhej, por edhe vëzhguesit e huaj e kanë kuptuar se televizionet kryesore në vend kanë vetëm një pronar para të cilit ulen në gjuhë dhe ai është pushteti i Edi Ramës.

“Asnjë nga partitë e tjera përveç PS dhe PD nuk mori më shumë se 5% të mbulimit në ndonjë nga televizionet e monitoruara,” thuhet në raportin paraprak të OSBE.

E vetmja mundësi e barabartë që u respektua formalisht ishte transmetimi i minutave falas nga RTSH, por në një televizion që raporti thotë se “nuk gëzon audiencë të gjerë” dhe që sipas raportit “nuk ka pavarësi të vërtetë për shkak të procedurave politike të emërimeve”.

Ky realitet i zymtë mediatik është pjesë thelbësore e mungesës së demokracisë në Shqipëri dhe vëzhgimet e ndërkombëtarëve nuk priten të ndryshojnë asgjë, por sigurisht që ato ia vlejnë të lexohen tani që priten të nisnin nga puna zjarrfikësit e debatit nëse pati manipulime në zgjedhje apo jo./Lapsi.al

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazonin biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946





**EXPRESS
DARDANIA
TRANSPORT**



QYTETET E GRUMBULLIMIT NE ANGLI

-London

-Birmingham

-Manchester

Pika Kryesore

7 Erconwald Street

London W12 0BP



QYTETET E GRUMBULLIMIT NE SHQIPERI

1- Koplik

2- Shkodër

3- Burrel

4- Kukës

5- Has

6- Fushë Krujë

7- Tiranë

8- Elbasan - Cërrik

9- Librazhd

10- Pogradec

11- Korçë

12- Durrës

13- Kavajë

14- Lushnje

15- Fier -

Patos/Roskovec

16- Vlorë

17- Ballsh

18- Memaliaj

19- Tepelenë

20- Gjirokastër

21- Sarandë

22- Delvinë

PIKA KRYESORE SHKODER TEK 5 HERONJT (SHUMICA)



07775374000

07552714087



+355 69 771 3344

+355 69 782 7032



JETA DEDJA

Në një vend malesh, ujërash të ëmbla e të kripura, pyjesh pa pemë e pa kafshë, mbretëronte ai: Mbreti i Çyrykëve, i mbathur me opinga e benevrekë, por pa kurorë në kokë. Por atij nuk i duhej kurorë për të dalluar nga të tjerët. Të gjithë e njihnin si Kryeçyrykun, një titull fisnik që, sipas legjendës, ia kishin qëndisur në ballë me fije ari dhe pluhur të bardhë, vetë Zanat e malit.

Çyrykët ishin njerëz si gjithë të tjerët, por me një veçori të vogël: kishin mësuar të rrinin shpinë-përkulur. Në fillim kishin qenë shtatdrejt, por ngaqë iu nënshtruan mbretit për shumë vite, shtyllat e tyre kurrizore u shtrembëruan, dhe tani ecnin si kërraba. Disa madje mburreshin: "Ne nuk thyemi kurrë. Ne manifestojmë klas-përkulje!"

Kryeçyryku nuk sundonte me shpata apo me ligje. Ai sundonte me batuta, gënjeshtër, tallje, ahengje dhe imazhe. Mjaftonte një fjali e lakuar bukur, një buzëqeshje e stërzgatur në ekran, dhe turma e çyrykëve shpërthente në duartrokitje si me komandë.

Në Mbretërinë e Çyrykëve nuk kishte ferma e fabrika, as bukë, as ujë. Por ky nuk ishte problem, sepse çyrykët nuk kishin nevojë të hanin e të pinin se ata ushqeheshin me fjalë.

Pikërisht për këtë arsye, në zemër të kryeqytetit ngrihej me krenari "Akademia e Çyrykërimin Kombëtar", një ndërtesë madhështore ku mësohej si të flisje gjatë pa thënë asgjë, si të



mbaje pozita me të njëjtin pozicion, si të mbaje ison e Kryeçyrykut në çdo tonalitet. Të rinjtë dërgoheshin atje që të mësonin si të mos pyesnin shumë dhe si të duartrokisnin në kohën e duhur, pa pyetur pse. Dhe ashtu bëheshin çyrykë të vërtetë.

Çdo agim, Kryeçyryku dilte në televizor dhe shpërndante racionin e ditës:

- "Ju solla dritën!"

- "Urta! Rroftë Mbreti!" - thërrisnin çyrykët me zell.

Në mbrëmje, ai kthehej sërish në

ekran për t'u dhënë vaktin para gjumit:

- "Çyrykët e mi! Jetoni në vendin më të pasur në botë. Keni shtëpitë më të bukura, tokën më pjellore, udhëheqësin më të pathyeshëm. Po jua fik dritat, që të shihni ëndrra me bukë lepurushi. U lodhët duke më adhuruar gjithë ditën."

Dhe turma shpërthente në duartrokitje dhe hop gjumë.

Sa herë ndodhte diçka e çuditshme; minerale që zhdokeshin, shtëpi e ura që shembeshin, një qytet që përm-

bytej, një shkollë që mbetej pa mësuat Kryeçyryku shfaqej menjëherë në ekran dhe me një ton solemn shpallte:

"Fajin e ka Shtrigani!"

Askush nuk dinte kush ishte ky Shtrigani, por të gjithë tundnin kokën të bindur. Dhe menjëherë pas fjalimit, organizohej një festë e madhe në sheshet e Jobarit, me muzikë, flamuj dhe fishekzjarre.

Por larg, shumë larg, në skajin e mbretërisë, ndodhej një fshat i vogël ku çyrykët nuk kishin vënë kurrë

këmbë. Aty njerëzit ecnin drejt, shikonin njëri-tjetrin në sy dhe flisnin pak, por mendonin shumë.

Një ditë, në atë fshat bujti një çyryk. Fshatarët, që nuk kishin parë kurrë më parë një njeri me kurriz të tillë të përkulur, i shtruan tryezën për të ngrënë. E mbushën me bukë, peshk të zënë në liqen, djathë të bardhë dhe një gotë ujë të kthjellët si vështrimi i tyre.

Por çyryku nuk po prekte gjë me dorë. Nuk dinte çfarë ishin ato sende mbi tavolinë. I shikonte si fëmijë që sheh për herë të parë botën.

"Pse nuk po e hani bukën tonë?" e pyeti një grua e moshuar. "Nuk ju pëlqen peshku? Doni një gotë ujë?"

Çyryku u hutua. Kishte harruar çfarë ishte buka dhe nuk dinte si të përgjigjej.

Atëherë, një fshatar aty pranë, me sy të kthjellët dhe buzëqeshje të qetë, foli me zë të ulët:

- "Sepse kur mbreti të ngop me fjalë, ai do që ti të harrosh çfarë është buka."

Dhe kështu, që prej asaj dite, ndërkohë që Kryeçyryku vazhdonte të shfaqej në ekrane, duke shpërndarë fjalë dhe broçkulla për të ushqyer çyrykët e tij, diku larg, në një fshat pa radio e pa televizione, e vërteta hodhi rrënjë.

Flasshqip.ca

"RAMA, NJË AUTOKRAT" / MEDIAT GJERMANISHFOLËSE: SISTEMI I TIJ KLIENTELIST I MIRËVAJOSUR I SIGURON SUKSESIN NË ZGJEDHJE

Gazeta "Neue Zürcher Zeitung", i ka kushtuar një artikull zgjedhje në vendin tonë. Pas zgjedhjeve në Shqipëri, media gjermanishtfolëse shkruan se Edi Rama do të jetë për herë të katërt kryetar qeverie i Shqipërisë. Gjithashtu në artikull shkruhet sistemi klientelist i mirëvajosur i Ramës është një shpjegim për suksesin zgjedhor të socialistëve. Në median gjermane, Rama portretizohet si vërtet proeuropian, artist jo konvencional që mirëpritet mjaft mirë në Bruksel, sepse politika është konform BE, por edhe mjaft i kontestuar.

Artikulli i Plotë:

Edi Rama do të jetë për herë të katërt kryetar qeverie i Shqipërisë- portret i një antikonformisti të përhershëm

Bumi i ndërtimeve me kalimin e kohës ka dëmtuar edhe reputacionin e Ramës si reformator. Në zhvillimin urban përqendrohet ajo që nuk shkon edhe në pjesën tjetër të Shqipërisë: nepotizmi ndan lejet e ndërtimit për njerëz të afërt, dhe dhënia e kontratave varet nga lidhjet politike, fondet e zeza dhe marrëveshjet nën dorë.

Në qendër të kësaj rrjete ndodhen partitë qeverisëse dhe kompanitë e lidhura me to. Suksesi i përsëritur i socialistëve të Ramës i atribuohet në masë të madhe këtij sistemi klientelist.

Në vitin 2013, ai e mundi për herë të parë armikun e tij të përbetuar, Sali Berishën, dhe u bë kryeministër. Rama ka gjasa ta mbajë këtë post edhe për katër vite të tjera, duke qëndruar kështu gjashtëmbëdhjetë vjet në pushtet.

Ajo që nuk shkon në shtet u bë e dukshme në shkurt, kur Erion Veliaj, kryebashkiaku i kryeqytetit dhe mik i ngushtë i Ramës, u arrestua së bashku me gruan e tij nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit. Ata akuzohen se kanë ndërtuar një sistem të sofistikuar vetëpasurimi në bashkëpunim me kompani ndërtimi dhe OJQ-të mike.



Rama shpërtheu në zemërim, thirri protesta dhe sulmoi gjyqtarët hetues. Me këtë, ai dëmtoi një reformë që vetë e kishte nisur në vitin 2017. Me

synim anëtarësimin në BE, drejtësia e rrënuar e vendit duhej të bëhej e pavarur dhe e fuqishme. Që nga ajo kohë, më shumë se gjysma e gjyqtarëve janë zëvendësuar dhe janë kri-

juar institucione të reja për luftën kundër korrupsionit. Që ato funksionojnë, tregohet nga aktakuza dhe arrestimi i Veliajt. Sistemi klientelist i mirëvajosur i Ramës është një shpjegim për suksesin zgjedhor të socialistëve.

Zgjedhje në Shqipëri: Sa autoritar është Edi Rama, pyet një nga radiot më të mëdha gjermane, "Dif" në një kronikë të gjerë të fundjavës.

Edi Rama është në BE një mik i mirëpritur, dhe duket se nga ana ideologjike dhe gjeopolitike qëndron i palëkundur në anën e Europës.

Por kritikët i tremben asaj se sukseset e Shqipërisë për temat si shteti ligjor dhe demokracia janë suksese vetëm në letër, dhe se vendi nuk është i gati për anëtarësim në BE. Kjo ka të bëjë edhe me Edi Ramën që tregon tipare autoritare.



RESTORANT PER SHITJE

Shitet nje restorant
I rinovuar, në një nga
zonat më të frekuentuara
të Londrës, në Romford
I hapur prej vitesh
me klientele te garantuar
Ambient fantastik per
festa, ditelindje,
fejesa martesë etj
Çmimi shumë i
arsyeshëm
Për më shumë info tel:


FOR SALE



07377 322424



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?



Search Engine
Marketing



Online
Advertising



Social Media
Marketing

PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TË VINI
NGA ZYRAT TONA



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



ADRESA E ZYRAVE
30 Avenons Road
London E13 8HT

VETON SURROI

Kosova mund ta ngushëllojë veten se është duke kërkuar një qendër të re politike që do ta udhëheqë vendin që është tashmë sfidë e madhe për demokracitë tradicionale të Evropës. Por, kërkimi i qendrës në Evropë është fillimi i një procesi të ri historik, e Kosova nuk mund të hyjë në të si spektatore pa qeveri me forcë legjitimiteti të shumicës së qytetarëve të vet.

1.

Ka shumë mënyra për ta analizuar krizën e tanishme politike në Kosovë lidhur me formimin e institucioneve qeverisëse pas zgjedhjeve që janë mbajtur tashmë para më shumë se tre muajsh. Njëra formë është ajo që tradicionalisht merret me personalitete, inate e teori të konspiracionit-pse ky lider sillet kështu, kush kë e ofendoi më shumë dhe kur e bëri këtë dhe çfarë sekretit fshihet prapa sjelljes së kësaj apo asaj partie?

Ka gjithsesi ushqim të mjaftueshëm për kësi lloj interpretimi. Po: ka inate, ka edhe ofendime, ka edhe duar të fshehura konspirative të interesave komerciale e të tjera që përfshihen në politikëbërje. Dhe s' do mend se kjo ndodh në Kosovë e në çdo vend tjetër të botës: kur në Kosovë flitet për ndikimin e oligarkive në politikë apo për politikën që po përpiqet të kufizojë interesat e biznesit apo edhe të medieve (që akuzohen se janë të kontrolluara prej oligarkive) një ligjërim i këtyllë ka mundur të kopjohet drejtpërsëdrejti prej demokracisë amerikane dhe akuzave e kundërakuzave të ngjashme. Ka mundur të kopjohet edhe prej ligjërimin të demokracive italiane, gjegjiane apo indiane. Politika nuk ka imunitet prej shoqërisë, është pjesë e saj.

Por, ekziston edhe një interpretim tjetër që ia vlen të shtjellohet, e ai është përpjekja për gjetjen e një qendre politike. Me një këso qasje, ditët që po përjetohen në Kosovë janë krizë për gjetjen e një qendre politike që do të jetë mjaftueshëm e fortë për ta shpënë vendin përpara, posaçërisht në epokën e pasigurisë që po e pëson bota që nga lufta ruse kundër Ukrainës dhe të fundit të Paqes amerikane.

Në këso interpretimi partitë politike, me shpërndarjen e votave ashtu si menduan votuesit e Kosovës pas revolucionit zgjedhor të para katër vjetëve me të cilin i dhanë mandat revolucionar një force politike, tash po e çajnë hallin se si të ndërtojnë një qendër të re politike në situatën ku nuk ekziston një mandat revolucionar.

2.

Nëse është kështu - me gjithë veçantitë e diskriminimit pozitiv të komuniteteve joshumicë me vendet e ndara në Kuvend - atëbotë Kosova nuk dallon shumë prej vendeve të tjera

DUKE KËRKUAR QENDRËN: KRIZA E HESHTUR KOSOVARE (DHE EVROPIANE)



evropiane. Belgjika, Holanda e Austria - vende me traditë të rrënjësor demokratike - brenda dy vjetëve të fundit shpenzuan muaj të tërë për të ndërtuar një pushtet të qendrës.

Kjo është kostoja e një procesi këmbëngulës dhe frytdhënës evropian të pasluftës së Dytë Botërore, pjesë e Paqes amerikane. Në të, pak me mjete publike e pak edhe me veprime të fshehta u ndërtua një traditë politike me të cilën u bë përpjekja që votuesit të largohet nga skajshmëritë e fashizmit dhe komunizmit e të kalojë sa më afër qendrës. Kështu u lind tradita kristian-demokrate e qendrës së djathtë dhe u forcua ajo socialdemokrate e qendrës së majtë. Dhe, që të gjitha lëvizjet e ndryshme u ftuan që të marrin pjesë në këtë ndarje, me nuancat e ndryshme të së djathtës e të majtës në mënyrë që pas zgjedhjeve të krijojnë qendrën.

Dhe, kjo traditë mund të quhet e gjallë me bisedat për koalicionet e me koalicionet e votuara, si ai dje në Gjermani, e nëse i shërben si ndonjë ngushëllim Kosovës, qytetarët e saj mund të arsyetohen se partitë e tyre po bëjnë saktësisht atë që bëjnë evropianët tradicionalisht, të kërkuarit e qendrës politike që do të jetë stabiliteti i pushtetit për periudhën e ardhshme.

3.

Problemi i këtij ngushëllimi është se qendra politike në botën perëndimore ka ndryshuar dhe po ndryshon për aq sa ajo më nuk ekziston siç u mësuam tradicionalisht.

Në dhjetor të vitit të kaluar në Washington një mik republikan që ishte tradicional e që tash bën pjesë në kampin e presidentit Trump pranoi vërejtjen time se ardhja e presidentit Trump në mandatin e tij të dytë ishte konfirmim se në Amerikë më nuk ekziston e djathta tradicionale e rrjedhimisht as e majta demokrate nuk mund të qëndrojnë në formën e vet tradicionale. Presidenti është duke riinterpretuar jo vetëm spektrin politik por edhe natyrën e demokracisë amerikane.

Shumë më herët një fenomen i këtyllë kishte ndodhur në Itali ku nga skena politike ishin zhdukur kristian-demokratët dhe socialistët, e djathta dhe e majta tradicionale. Në vend të tyre, qendra e sotme politike italiane përfaqësohet nga një forcë politike që deri dje konsiderohej si e djathtë e skajshme, e quajtur "neofashiste" madje, e prirë nga kryeministria Meloni.

Modeli italian u replikua në një masë në Francë me zbehjen e forcave politike tradicionale dhe sot lufta për qendrën politike nuk është mes të majtës e djathtës, por mes presidentit centrist

Macron dhe të djathtës së skajshme me Marie Le Pen; një president pa shumicë, një parlament pa qartësi, një republikë që e ndien se po i skadon energjia politike.

Dhe qendra gjermane, përkundër forcës së koalicionit të partive tradicionale CDU/CSU me SPD, është nën presion të madh nga forca e cila është tashmë e parë politike, AfD e ekstremit të djathtë, e shpallur si rrezik për sigurinë kombëtare nga shërbimi sekret gjerman BND.

Ky është tashmë realitet edhe në periferinë evropiane, siç u dëshmuua me votën presidenciale rumune, ku votuesit po tregojnë se do të hedhin jashtë lojë partitë tradicionale të vetëquajtura të majta e të djathta. Votuesi rumun gjithnjë e më shumë parapëlqen mesazhin nacionalist, të zhveshur prej nocioneve ideologjike tradicionale të së majtës e të djathtës, dhe të zhveshur po ashtu prej nocioneve të përgjegjësive e solidaritetit evropian.

MAGA - lëvizja amerikane e Trumpit, po klonohet në Hungari, Rumani e Sllovakia, vende të NATO-s që tash po kërcënohen të shndërrohen në vende me antipati të dukshme për çdo gjë që u konsiderua "modë" liberale (përkrahje e refugjatëve, të drejtave homoseksuale, etj.) dhe me simpati për Rusinë e Putinit.

Ky është përcaktimi i ri i nocionit "Qendër politike" në një pjesë të konsiderueshme të Evropës.

4.


Ngushëllimi kosovar mund të jetë që përpjekja për të gjetur qendrën politike nuk është shumë e ngjashme me atë të pjesës tjetër të Evropës, së paku jo asaj tradicionale. Pra, jo, problemi nuk është ideologjik i ndonjë konfrontimi mes të majtës tradicionale dhe të djathtës tradicionale - për faktin e thjeshtë se në Kosovë ende nuk ka të majtë e të djathtë tradicionale. Ende nuk ka përvojë të mjaftueshme që do të meritonte emrin traditë.

Por, ky nuk është ndonjë ngushëllim i qëndrueshëm. Evropa e qendrës tradicionale pothuajse nuk ekziston më dhe kemi hyrë në epokën ku po përcaktohet se çka do të jetë qendra. Dhe, kjo është një epokë pasigurie në të cilën po ndërtohet një konstatim logjik: Evropa ka hyrë në procesin e kërkimit të qendrës së vet të re dhe ky do të jetë proces i gjatë historik që ka filluar tani por Kosova nuk e ka luksin që ta vëzhgojë këtë proces pasigurie duke mos e pasur qendrën e vet të konsoliduar.

Vendimin për këtë - me koalicion të ri tash a pas zgjedhjeve të reja imediate -partitë dhe votuesit e tyre duhet ta marrin shpejt.

NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Temperature
- Pulse
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



**TELEFONONI SHQIP
07468 759953**



**141 CHRISTIAN STREET
LONDON E1 1RS
TEL: 02081096550**

**A DËSHIRONI TË BËHENI ELEKTRIÇIST
I KUALIFIKUAR?**

**A DËSHIRONI
GOLD CARD?**



**18 edition - Level 3 Award in the
Requirements for Electrical
Installations BS 7671:2018**

**EAL Level 3 Award in Electrical
Installation Inspection,
Testing, Certification and
Reporting 603/2625/6**

**501/1605/8 Installing
Electrotechnical Systems and
Equipment NVQ**

**AM2 Assessment of
Occupational Competence**



**COLLEGE OF
LONDON ME
PRONAR SHQIPTAR**



**www.collegeoflondon.org.uk
info@collegeoflondon.org.uk**